R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1352/6 prot. Tiranë, më 15.07.2026

REKOMANDIM

Nr. 43, datë 15.07.2026

PËR KONTROLLUESIN, SHOQËRIA "RUBICON/PAGO" SHPK

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (në vijim "Ligji"), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" (në vijim "Kodi i Procedurave Administrative"), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit "RUBICON/PAGO" sh.p.k. (në vijim "Kontrolluesi"),

KONSTATOHET SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 112, datë 18.05.2026, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri"), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (në vijim "Ligji"), me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të të dhënave personale (PIMS)".*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS M02129014T, me objekt aktiviteti "Emetim të parasë elektronike, këmbim valutor, ofrimin e shërbimit të pagesave, kryerje veprimtarie si agjent në sigurime, shërbime këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtaritë financiare për të cilat shoqëria licencohet nga Banka e Shqipërisë etj.".

   Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e të dhënave "punonjës", "klientë", "vizitorë" etj. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi, ndër të tjera, përpunon të dhëna personale të subjekteve të të dhënave punonjës, vizitorë, nëpërmjet dosjeve fizike dhe në mënyrë elektronike (faqe e internetit etj.). Megjithatë, Kontrolluesi nuk ka vendosur në dispozicion dokumentacion provues lidhur me asgjësimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, për të cilat ka përfunduar qëllimi i përpunimit të tyre, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit.

   Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, rezulton se Kontrolluesi nuk ka hartuar procedura të qarta për fshirjen, asgjësimin ose anonimizimin e të dhënave personale pas përfundimit të afatit të ruajtjes, si dhe mekanizma monitorimi dhe auditimi të brendshëm për të garantuar zbatimin efektiv të këtyre afateve.

   Konstatohet se të dhënat e mbledhura nga Kontrolluesi ruhen pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 6 të Ligjit, që nënkupton se të dhënat personale mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për një periudhë jo më të gjatë sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato përpunohen, dhe Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011, të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat", i ndryshuar (në vijim "Udhëzimi nr. 11").

   Zyra e Komisionerit vlerëson se lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër sesa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5 të nenit 6 të Ligjit.

   Gjithashtu, Kontrolluesi duhet të hartojë procedura të qarta për fshirjen, asgjësimin ose anonimizimin e të dhënave personale pas përfundimit të afatit të ruajtjes, si dhe mekanizma monitorimi dhe auditimi të brendshëm për të garantuar zbatimin efektiv të këtyre afateve. Në rastet kur të dhënat ruhen për periudha më të gjata për qëllime arkivore në interes publik, për qëllime kërkimore apo statistikore, duhet të aplikohen masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar minimizimin e të dhënave dhe kufizimin e aksesit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5 të nenit 6 të Ligjit.

   Referuar nenit 27 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin të mbajë dokumentacion për veprimtaritë e tij përpunuese, në mënyrë që të jetë në gjendje të japë të dhëna lidhur me përputhshmërinë me këtë ligj. Në këtë kuadër, mosdisponimi dhe mosdokumentimi i procedurave të brendshme rregullatore për asgjësimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, për të cilat ka përfunduar qëllimi i përpunimit të tyre, sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit, si dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013, të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të

dhënave personale", demonstron mungesë të rregullimit të brendshëm për pajtueshmëri dhe mungesë të kapaciteteve organizative për garantimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së të dhënave personale.

3. Konstatohet se Kontrolluesi ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi, datë 18.10.2024, me subjektin "IMAGE & COMMUNICATIONS DEVELOPMENT" sh.p.k. (në vijim "DEV"), me NUIS L01511027P, me seli në adresën: Njësia Administrative Nr. 5, rruga "Donika Kastrioti", pallati Tekno-Projekt, apartamentet 5/1 dhe 5/6, Tiranë, Shqipëri. Në kuadër të këtij Memorandumi, DEV administron infrastrukturën fizike të ambienteve ku Kontrolluesi ushtron veprimtarinë e tij, duke përfshirë sistemin e video-survejimit (CCTV) të instaluar në këto ambiente, si dhe ka akses në sistemet e brendshme, databazat e klientëve dhe infrastrukturën teknologjike të Kontrolluesit.

   Nga analizimi i përmbajtjes së Memorandumit të Bashkëpunimit datë 18.10.2024 dhe Aneksit nr. 1 të tij, konstatohet se Aneksi nr. 1 adreson vetëm përpunimin e të dhënave personale të regjistruara nga sistemi CCTV. Nuk rezulton të jetë lidhur asnjë kontratë apo marrëveshje tjetër ndërmjet Kontrolluesit dhe DEV, e cila të rregullojë të gjitha aktivitetet e tjera të përpunimit të të dhënave personale që kryhen në kuadër të marrëdhënies kontraktore midis palëve, si administrimi i infrastrukturës fizike, aksesi në sistemet e informacionit dhe çdo aktivitet tjetër përpunimi që rrjedh nga ushtrimi i veprimtarisë së DEV në ambientet dhe sistemet e Kontrolluesit.

   Sa më sipër, Kontrolluesi dhe DEV nuk kanë lidhur një kontratë/marrëveshje në të cilën të specifikohen masat konkrete tekniko-organizative të detyrueshme për t'u zbatuar nga DEV për të gjitha aktivitetet e përpunimit të të dhënave personale që kryhen në kuadër të marrëdhënies kontraktore midis palëve, si dhe nuk janë reflektuar të gjitha detyrimet midis kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas parashikimeve të nenit 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012, të Komisionerit "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi", i ndryshuar (në vijim "Udhëzimi nr. 19").

   Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo delegim i përpunimit të të dhënave personale duhet të realizohet përmes një kontrate/marrëveshje të shkruar dhe të detajuar, e cila përcakton qëllimin e përpunimit, kategoritë e të dhënave, masat e sigurisë që do të zbatojë përpunuesi, përgjegjësitë ligjore dhe procedurat për kontrollin dhe raportimin. Kjo siguron që delegimi të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 26 të Ligjit.

4. Rezulton se Kontrolluesi ka marrë pjesërisht masat teknike dhe organizative për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut të ruajtjes së të dhënave personale të ruajtura në sistemet dhe databazat e tij. Kontrolluesi ka dorëzuar si dokumentacion reference Manualin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ISMS Manual v1.0, datë 01.01.2026), Politikën e Kontrollit të Akseseve (ACP_P-01, datë 02.08.2025), Planin e Rikuperimit nga Fatkeqësitë

(ISMS-DOC-DRP-1), Politikën e Krijimit të Backup dhe Rikuperimit (BRP-01) dhe Politikën e Regjistrimit dhe Monitorimit të të Dhënave (DLP-01), të cilat përmbajnë referenca ndaj parimit të enkriptimit, ruajtjes së të dhënave, planifikimit të rikuperimit dhe disponueshmërisë së kontaktit në rast krize kibernetike.

Nga analizimi i materialit të dorëzuar, Zyra e Komisionerit evidenton se dokumentacioni plotëson një sërë hallkash dhe procesesh që përmbajnë si detyrim mbrojtjen e të dhënave personale, por gjithashtu evidentohen disa mangësi, ndër të cilat:

Nga Raporti i Penetration Test të kryer nga Axians Macedonia, datë 07.03.2025, disa cenime lidhur me masat e enkriptimit dhe sigurisë në transmetim nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë dhe efektive. Pavarësisht Raportit të Penetration Test, Kontrolluesi nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokumentacion për të provuar adresimin dhe korrigjimin e cenueshmërive të konstatuara.

Sa më sipër, Kontrolluesi nuk ka marrë masat e duhura teknike dhe organizative për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, duke përfshirë, ndër të tjera, rrjedhjen e të dhënave personale si pasojë e dobësive të gjetura nga raporti i auditimeve të sigurisë sipërcituar, si:

- SQL Injection (CVSS v4.0: 9.4/Critical) – dobësi përmes së cilës një aktor keqdashës ekzekuton komanda të paautorizuara në bazën e të dhënave, si pasojë e së cilës mund të realizohet aksesimi, ndryshimi ose fshirja e të dhënave personale, duke cenuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e tyre;
- Unauthorized Email Sending (CVSS v4.0: 8.5/High) – dobësi që mund të shkaktojë zbulimin e paautorizuar të të dhënave personale dhe shpërndarjen e përmbajtjeve konfidenciale nëpërmjet dërgimit të *e-mail*-eve të paautorizuara;
- Denial of Service (CVSS v4.0: 8.5/High) – sulm i cili mund të shfrytëzohet si mjet për të dobësuar mekanizmat e mbrojtjes dhe për të cenuar konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave personale,

në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale" (në vijim "Vendimi nr. 6").

Kontrolluesi, për shkak të veprimtarisë së tij, nuk ka marrë masa për të krijuar, zbatuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme një Sistem Menaxhimi të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System "PIMS"*), sipas Udhëzimit nr. 09, datë 20.11.2025 "Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale" (në vijim "Udhëzimi nr. 09") .

Gjithashtu, konstatohet se Kontrolluesi nuk mban dokumentacion mbi veprimtaritë e përpunimit, me qëllim demonstrimin e përputhshmërisë me Ligjin, në formë të shkruar dhe në format elektronik, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit. Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veprimtarisë që

ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi duhet të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë një PIMS në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 09.

Bazuar në nenin 13 të Udhëzimit nr. 09 dhe nenin 28 të Ligjit, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete teknike dhe organizative që garantojnë nivel të përshtatshëm për rrezikun, masa të cilat duhet të rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar efektivitet të vazhdueshëm. Referuar nenit 27 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin të mbajë dokumentacion, në format të shkruar dhe elektronik për veprimtaritë e tij përpunuese, në mënyrë që të jetë në gjendje të japë të dhëna lidhur me përputhshmërinë me këtë ligj. Referuar nenit 27, pika 4 e Ligjit, çmohet se Kontrolluesi nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përjashtuara nga detyrimet e nenit 27, pikat 1 dhe 2 të Ligjit pasi, edhe pse ka më pak se 250 (dyqind e pesëdhjetë) persona të punësuar, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij të biznesit ai bën përpunim të rregullt e të shtrirë në kohë (pra jo rastësor) për kategorinë e të dhënave "punonjës", "klientë" etj. (*shih pika 4 e nenit 27 të Ligjit*).

Mungesa e këtij dokumentacioni dhe mosrespektimi i procedurave të brendshme rregullatore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, sipas kërkesave të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, si dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit, demonstron mungesë të rregullimit të brendshëm për pajtueshmëri dhe mungesë të kapaciteteve organizative për garantimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së të dhënave personale.

Kontrolluesi, duke marrë në konsideratë natyrën e veprimtarisë së tij, nuk ka marrë masa për të krijuar, zbatuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme një Sistem Menaxhimi të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System "PIMS"*), sipas Udhëzimit nr. 09, datë 20.11.2025 "Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale" (në vijim "Udhëzimi nr. 09").

Kuadri ligjor evropian mbi mbrojtjen e të dhënave personale të cilin Ligji transpozon dhe praktika më e mirë evropiane e konsideron certifikimin si një mekanizëm përputhshmërie me Ligjin[1], dhe për të inkurajuar zbatimin e tij i krijon rast pas rasti kontrolluesve që e zbatojnë atë në mënyrë efektive një pozitë preferenciale në kryerjen e disa veprimtarive përpunuese të caktuara, siç janë transferimet ndërkombëtare. Në këtë kuadër, në zbatim të nenit 37 të Ligjit, i cili parashikon dhe rregullon mekanizmin e certifikimit, Komisioneri ka miratuar Udhëzimin nr. 08, datë 20.11.2025 "Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues" (në vijim "Udhëzimi nr. 08") dhe Udhëzimin nr. 09.

Udhëzimi nr. 09 referon në Sistemet e Menaxhimit të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System "PIMS"*) dhe Komisioneri inkurajon kontrolluesit, të cilët për shkak të natyrës së veprimtarisë së tyre e kanë të nevojshme ngritjen e një

[1] *Pika 3 e nenit 22, pika 3 e nenit 28*

sistemi të tillë me qëllim standardizimin dhe rregullimin e veprimtarisë përpunuese dhe garantimin e sigurisë së përpunimit të të dhënave personale, të zbatojnë Udhëzimet nr. 08 dhe nr. 09.

Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi duhet të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë një sistem menaxhimi të të dhënave personale (PIMS), në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 09.

Bazuar në nenin 28 të Ligjit dhe nenin 13 të Udhëzimit nr. 09, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete teknike dhe organizative, që garantojnë nivel të përshtatshëm për rrezikun, masa të cilat duhet të rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar efektivitet të vazhdueshëm.

Referuar nenit 27 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin të mbajë dokumentacion, në format të shkruar dhe elektronik, për veprimtaritë e tij përpunuese, në mënyrë që të jetë në gjendje të japë të dhëna lidhur me përputhshmërinë me këtë ligj. Referuar nenit 27, pika 4 e Ligjit, çmohet se Kontrolluesi nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përjashtuara nga detyrimet e nenit 27, pikat 1 dhe 2 të Ligjit pasi, edhe pse ka më pak se 250 (dyqind e pesëdhjetë) persona të punësuar, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij të biznesit ai bën përpunim të rregullt e të shtrirë në kohë (pra jo rastësor) për kategorinë e të dhënave "punonjës", "klientë" etj. (*shih pika 4 e nenit 27 të Ligjit*).

Mungesa e këtij dokumentacioni dhe mosrespektimi i procedurave të brendshme rregullatore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, sipas kërkesave të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, si dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit, demonstron mungesë të rregullimit të brendshëm për pajtueshmëri dhe mungesë të kapaciteteve organizative për garantimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së të dhënave personale.

Kontrolluesi, duke marrë në konsideratë natyrën e veprimtarisë së tij, nuk ka marrë masa për të krijuar, zbatuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme një Sistem Menaxhimi të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System "PIMS"*), sipas Udhëzimit nr. 09, datë 20.11.2025 "Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale" (në vijim "Udhëzimi nr. 09").

Kuadri ligjor evropian mbi mbrojtjen e të dhënave personale, të cilin Ligji transpozon dhe praktika më e mirë evropiane, e konsideron certifikimin si një mekanizëm përputhshmërie me Ligjin dhe për të inkurajuar zbatimin e tij, i krijon rast pas rasti kontrolluesve që e zbatojnë atë në mënyrë efektive, një pozitë preferenciale në kryerjen e disa veprimtarive përpunuese të caktuara, siç janë transferimet ndërkombëtare. Në këtë kuadër, në zbatim të nenit 37 të Ligjit, i cili parashikon dhe rregullon mekanizmin e certifikimit, Komisioneri ka miratuar Udhëzimin nr. 08, datë

20.11.2025 “Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues” (në vijim “Udhëzimi nr. 08”) dhe Udhëzimin nr. 09.

Udhëzimi nr. 09 referon në Sistemet e Menaxhimit të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System “PIMS”*) dhe Komisioneri inkurajon kontrolluesit, të cilët për shkak të natyrës së veprimtarisë së tyre e kanë të nevojshme ngritjen e një sistemi të tillë me qëllim standardizimin dhe rregullimin e veprimtarisë përpunuese dhe garantimin e sigurisë së përpunimit të të dhënave personale, të zbatojnë Udhëzimet nr. 08 dhe nr. 09.

Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi duhet të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë një sistem menaxhimi të të dhënave personale (PIMS), në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 09.

Bazuar në nenin 28 të Ligjit dhe nenin 13 të Udhëzimit nr. 09, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete teknike dhe organizative, që garantojnë nivel të përshtatshëm për rrezikun, masa të cilat duhet të rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar efektivitet të vazhdueshëm.

5. Konstatohet se Kontrolluesi ka emëruar nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave personale (DPO). Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin e njoftimit të Zyrës së Komisionerit për emërimin e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 34 të Ligjit.

   Zyra e Komisionerit vlerëson se DPO shërben si pikë kontakti zyrtar midis Kontrolluesit, Komisionerit dhe subjekteve të të dhënave, duke lehtësuar komunikimin e shpejtë, bashkëpunimin dhe trajtimin e menjëhershëm të kërkesave, ankesave apo cenimeve të të dhënave. Ky njoftim kontribuon në plotësimin e regjistrit elektronik qendror të DPO-ve, duke siguruar transparencë të plotë dhe duke kontribuuar drejtpërdrejt në forcimin e përputhshmërisë ligjore, parandalimin e shkeljeve dhe shmangien e pasojave të rënda, duke mbrojtur në fund të drejtat dhe liritë themelore të individëve.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare dhe në formë elektronike.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore, të datës 07.07.2026, të organizuar nga Zyra e Komisionerit, gjatë së cilës ka deklaruar angazhimin për

rekuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si dhe bashkëpunimin me Komisionerin për të siguruar që çdo mangësi të adresohet në përputhje me Ligjin.

Gjithashtu, paraprakisht nga ana e Kontrolluesit, me shkresën nr. 89 prot., datë 07.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1352/5 prot., datë 07.07.2026, janë përcjellë me relacion shpjegues të gjitha masat e marra në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore, si dhe dokumentacionin si vijon:

- Dokumentacion për asgjësimin e të dhënave personale:
- Memorandum i bashkëpunimit;
- Masat teknike dhe organizative;
- Lidhur me PIMS;
- Njoftim i emërimit të DPO.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 26, 27, 28, 34, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit, Komisioneri,

REKOMANDON:

1. Kontrolluesi, shoqëria “RUBICON/PAGO” sh.p.k., të marrë masa për caktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me pikën 5 të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm; si dhe të hartojë procedura të qarta për fshirjen, asgjësimin ose anonimizimin e të dhënave personale pas përfundimit të afatit të ruajtjes, si dhe mekanizma monitorimi dhe auditimi të brendshëm për të garantuar zbatimin efektiv të këtyre afateve;

2. Kontrolluesi, shoqëria “RUBICON/PAGO” sh.p.k., të marrë masa për hartimin dhe lidhjen e marrëveshjes me përpunuesin, duke specifikuar detyrimet midis palëve, masat tekniko-organizative, sipas detyrimeve të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19;

3. Kontrolluesi, shoqëria “RUBICON/PAGO” sh.p.k., të marrë masa për publikimin e të dhënave të kontaktit të nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale në faqen zyrtare të internetit https://pago.al;

4. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:

i) vazhdimisht, detyrimi i përcaktuar në pikën 1 më sipër;
ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikat 2 dhe 3 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

5. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve;

6. Komisioneri, bazuar në shkronjën "a" të pikës 2 të nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me Ligjin. Në rast të moszbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 15.07.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi